
THE TREATMENT OF SOCIAL ISSUES IN THE LISBON TREATY TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE SOCIALE NË TRAKTATIN E LISBONËS

ABDULLA AZIZI

Universiteti i Evropës Juglindore, Rr. Ilindenska pn. Tetovë, 1200, R. E MAQEDONISË
a.azizi@seeu.edu.mk

AKTET V, 4: 521-526, 2012

PËRMBLEDHJE

Traktati i Lisbonës është një përpjekje për të kapërcyer mangësitë në funksionimin e traktateve të mëparshme të Bashkimit Evropian në të gjitha fushat e veprimit. Ai synon që përmes dispozitave të tij të ofrojë mundësi më të mira në trajtimin edhe të çështjeve sociale. Konkretisht, objektivi i këtij punimi është që të shtron aspektet sociale më kryesore të Traktatit në fjalë, duke përdorur metodën deskriptive, atë kopparative dhe analizën e dispozitave të deritanishme sociale në kuadër traktateve të deritanishme. Rezultatet e punimit do të përqëndrohen në konkretizimin, ndarjen e kompetencave, koordinimin si dhe kompetencat e përbashkët të BE-së dhe shteteve anëtare në këtë fushë. Në përfundim të punimit shtrohen përparësitë e Traktatit të Lisbonës, si dokument bazë i cili jep kahje zgjidhjes së problemeve ekzistuese dhe është në hap të ballafaqohet me sfidat e kohës. Megjithatë, duke pasur parasysh se në botën bashkëkohore dallimet mes njerëzve të varfër dhe atyre të pasur janë gjithnjë e më tepër të theksuara, duket se ky Traktat nuk do të siguron drejtësinë sociale.

Fjalë kyçe: Traktati i Lisbonës, Politika Sociale, punësimi.

SUMMARY

The purpose of this paper is to study the impact of institutional factors on the growth of small and medium enterprises (SMEs). Kosovo, as one of the last countries in transition characterized by difficult social and economic conditions, is used as a case study in this paper. The main institutional obstacles faced by SMEs in Kosovo that are involved in international trade will be analyzed from the perspective of the institutional theory developed by North (1990). The study is based on interviews of firms in Kosovo, using a structured questionnaire, conducted in 2010. The paper's key findings show that informal activities caused by low levels of professional and ethics of officials in respective institutions, as well as poor enforcement of regulations, have significant impact on increasing transaction costs, which in turn represents a major obstacle to the further growth of SMEs.

Key words: Growth, institutional barriers, SMEs, Kosovo.

HYRJE

Edhe pse Traktati i Lisbonës parasheh autorizime të reja në fushën e politikës sociale për Bashkimin Evropian, megjithatë ajo mbetet brenda fushës së kompetencave të shteteve anëtare.¹ Konkretisht, politika sociale është numëruar në listën e kompetencave të ndara mes BE-së dhe

shteteve anëtare (neni 4b i Traktatit mbi funksionimin e UE-së, TFUE). Ndersa, neni 5(2) e autorizon Unionin që të ndërmer masa për të siguruar koordinimin e politikave të punësimit në shtetet anëtare dhe mund të mer iniciativë për të siguruar koordinimin e politikave sociale të shteteve anëtare [neni 5(3)].

Dispozitat sociale më tepër qartësojnë sesa zgjerojnë kompetencat e mëparshme, që janë përcaktuar në nenin 3(1) dhe nenet 136–145 të TFUE.

¹ "The Lisbon Treaty: 10 easy-to-read fact sheets", Fondation Robert Schuman, Bruksel, Dhjetor 2007, f. 20; Burimi: www.robert-schuman.eu

1. Zhvillimi i politikës sociale të BE-së deri në Traktatin i Lisbonës

Si rezultat i proceseve të përgjithshme euro-integruese, të rëndësishme janë edhe aktivitetet e BE-së në krijimin e politikës sociale, ndërsa kujdes të veçantë u është përkushtuar atyre çështjeve sociale të cilat trajtohen ndryshe nga ana e shteteve-anëtare.²

BE-ja i trajton situatat e zhvillimit të marrëdhënieve të punës dhe propozon masa për zgjidhje të suksesshme të të gjitha problemeve të cilat paraqiten në këtë sferë. Politika e saj sociale i përfshin çështjet që kanë të bëjnë me: harmonizimin e politikës së barazisë dhe jodiskriminimit në bazë të moshës, gjinisë, prejardhjes etnike dhe religjionit; harmonizimit të të drejtave kolektive dhe individuale të punëtorëve; koordinimit të mbrojtjes sociale dhe mirëqenies së popullatës; zvogëlimin të papunësisë; ndarjes së obligimeve familjare dhe profesionale; mbrojtjes së grupeve të posaçme të popullatës (të hendikepuar, fëmijë, gra etj) dhe të drejtat e tyre.

Objektivi i BE-së është që përmes politikës sociale të promovon punësimin, përmirësimin e kushteve për jetesë dhe punë, sigurimin e nivelit të duhur të mbrojtjes sociale, promovimin e dialogut social dhe luftën kundër marginalizimit social. Politika sociale në BE si dhe rregullimi i marrëdhënieve nga sfera sociale midis shteteve-anëtare është aktuale më se 60 vjet, ndërsa bazat për veprim të BE-së në këtë sferë janë të përmbledhura në traktatet themeluese të Komuniteteve Evropiane dhe në Traktatin e BE-së (legjislacionin primar), në aktet e miratuara nga institucionet e BE-së (legjislacionin sekondar) në suaza të kompetencave të tyre, në Konventat e nënshkruara nga ana e shteteve-anëtare dhe programet e BE-së për zhvillim të politikës sociale.

Në fillim të veprimit të Komuniteteve nuk u përkushtua vëmendje e duhur çështjeve sociale, pasi që në rend të parë marrëveshjet themeluese

ishin përkushtuar çështjeve ekonomike, ndërsa aktivitetet e saj në fushën sociale ishin të kushtëzuara si nevojë për gjetjen e zgjidhjeve për funksionimin e tregut të përbashkët, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, si dhe ndalimit të diskriminimit të punëtorëve dhe popullatës tjetër joaktive. Më vonë, si rezultat i ndryshimeve teknologjike, strukturore dhe politike, zgjerimet e mëtejshme dhe trendet socio-demografike në BE, u paraqit nevoja për koordinimin e politikës sociale në shtetet-anëtare të BE-së.

Standardet e përbashkëta në sferën sociale në fillim të themelimit të KE-ve kishin të bëjnë me rrogat dhe lëvizjen e punëtorëve në miniera, ndalimin e diskriminimit lidhur me rrogat dhe kushtet për punë të punëtorëve-emigrant. Kjo ishte vërtetuar me Traktatin e Komunitetit për thëngjill dhe çelik (1951), dhe përveç kësaj i vuri standardet themelore për mbrojtje të shëndetit të punëtorëve në industrinë e thëngjillit dhe çelikut.

Mirëpo, bazat e politikës sociale të KE-ve gjenden në Traktatin për Bashkësi Ekonomike Evropiane (1957), i cili kishte objektiv kryesor themelimin e tregut të përbashkët, funksionimi i të cilit e parashtrroi zgjidhjen e disa çështjeve sociale. Në këtë drejtim, të rëndësishme ishin aktivitetet e parashikuara në mbrojtjen themelore sociale, shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve dhe anëtareve të familjeve të tyre në nivel të BE-së. Kjo për shkak të faktit se rregullimi i ndryshëm i këtyre çështjeve do të kishte ndikim negativ mbi konkurrencën në tregun e përbashkët, si dhe standardin e jetesës dhe punës.

Paralelisht me ndodhitë e proceseve të tërësishme integruese, kanë rrjedhur edhe aktivitetet e Komuniteteve në zhvillimin e politikës sociale. Në vitet e 80-ta, qeveritë e shteteve-anëtare më tepër ishin fokusuar në rregullimin e tregut të punës dhe në këtë drejtim ishin miratuar disa direktiva për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve. Akti Unik Evropian (1986) përkushtoi vëmendje të veçantë politikës sociale, veçanërisht shëndetit dhe sigurisë në punë, dialogut me partnerët social dhe kohezionit ekonomik dhe social. Ai solli novitet i cili kishte të bëjë me harmonizimin e kushteve për shëndet

² Azizi A., "Puna dhe politika sociale në Bashkimin Evropian", Tetovë, 2009, f. 55-57

dhe siguri profesionale në rajone me nivel më të ulët të mbrojtjes sociale.

Të drejtat sociale ishin më detaisht të përpunuara dhe zhvilluara përmes Kartës për të drejtat themelore të punëtorëve (1989), Konventës për të drejtat fundamentale të BE-së (2000), direktivave të Këshillit të BE-së (ku ishin sqaruar detajet e zbatimit të tyre), mirëpo ndikim të rëndësishëm ushtruan edhe Karta sociale evropiane (1961) dhe Kodeksi evropian i mbrojtjes sociale (1964), të miratuara nga Këshilli i Evropës, të cilat ishin implementuar edhe nga shtetet-anëtare të BE-së.

Traktati i Mastroitit parashihte bazë juridike për harmonizimin e të drejtave në sferën e punës dhe politikës sociale, ndërsa njëkohësisht solli kapitull të ri mbi arsimin dhe trajnimin profesional. Përveç funksionimit të tregut të përbashkët dhe përafrimit të politikave të shteteve-anëtare, si objektiv kryesor e parashikoi përmirësimin e standardit për jetesë dhe harmonizimin e politikës sociale. Po ashtu, ishte lidhur Marrëveshja për politikë sociale, e cila për shkak të kundërshtimit të Britanisë së Madhe nuk ishte implementuar në këtë traktat, mirëpo disa vite më vonë u implementua në Traktatin e Amsterdimit, e cila ndër të tjerat solli: masa kundër marginalizimit social, masa për zgjerimin e mundësive të barabarta dhe ndërrimin e procedurës së bashkë-vendosjes për shumë çështje nga sfera sociale, e promovoi punësimin si objektiv kryesor dhe përcaktoi udhëzime për plotësimin e aktiviteteve të shteteve-anëtare në zhvillimin e Strategjisë së koordinuar për punësim, veçanërisht përmes sigurimit të fuqisë punëtore të kualifikuar, trajnuar dhe përshtatur ndaj ndryshimeve ekonomike.

Për koordinim më të mirë të politikës së mbrojtjes sociale, Traktati i Nicës themeloi trup të ri, i njohur si Komitet për mbrojtje sociale, ndërsa Komisioni përgatiti Agjendë për politikën sociale për 5 vitet e ardhshme, në të cilën ishin të parapara aksione prioritare të BE-së që kishin të bëjnë me: rritjen e nivelit të punësimit, luftën kundër varfërisë dhe marginalizimit, modernizimin e mbrojtjes sociale, promovimin e

barazisë gjinore dhe përforcimin e aspekteve sociale të zgjerimit.

Po ashtu, për shkak të ruajtjes së kontinuitetit të aktiviteteve të BE-së, Komisioni përgatiti Agjendë të re për politikën sociale për periudhën 2006-2010, në të cilën janë identifikuar prioritetet e veprimt, veçanërisht në krijimin e ekonomisë konkurruese të bazuar në dije, si dhe zhvillimin e "modelit social evropian". Për realizimin e këtyre objektivave, lindi nevoja e dizajnit të politikave të tilla ekonomike dhe sociale, të cilat do të ishin të harmonizuara me nevojat e qytetarëve të BE-së.

2. Risitë dhe ndryshimet në fushën sociale me Traktatin e Lisbonës

Në Traktatin e Lisbonës janë përfshirë edhe Konventa për të drejtat themelore dhe Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut.

Traktati i Lisbonës ndryshon nenin 6 të Traktatit të BE-së (Traktatin e Mastroitit), për të mundësuar njohjen e Konventës për të drejtat themelore, e proklamuar në Konferencën ndërqeveritare në Nicë (dhjetor 2000).

Konventa mbulon ndër të tjerat mbulon edhe të drejtat sociale dhe ekonomike, siç janë: e drejta për gjykim të drejtë dhe kushte të drejta për punë, si: dhe e drejta për jetë familjare dhe profesionale; lirinë e zgjedhjes së profesionit dhe të drejtën e angazhimit në punë; të drejtën e punëtorëve në informim dhe konsultim brenda ndërmarrjes; të drejtën e marrëveshjeve dhe veprimeve kolektive; mbrojtjen në rast të lëshimeve të paarsyeshme.

Traktati i Lisbonës garanton se këto të drejta kanë fuqi të detyrueshme juridike, që kur këto të drejta të garantohen nga gjykatësit në nivel nacional dhe ato të komunitetit. Fakti se ato do të kenë vlerë të njëjtë juridike sikur edhe traktatet e komunitetit është me rëndësi pasi që ai do t'u mundëson atyre të njihen ose të interpretohen në mënyrë të re që të mund të sjell benefite të reja për individët.

Përveç kësaj, të drejtat që dalin nga Konventa korrespondojnë me ato të përcaktuara në Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Pranimi i Konventës Evropiane për të drejtat e

njeriut nënkupton se UE dhe institucionet e saj do të përgjigjet përpara Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut për çështjet që kanë të bëjnë me Konventën evropiane për të drejtat e njeriut. Me fjalë tjera, institucionet e UE mund të jenë subjekt i drejtpërdrejtë i Konventës për të drejtat e njeriut dhe Gjykata Evropiane do të mund drejtpërdrejtë të aplikojnë Konventën si pjesë e së drejtës së UE-së.

Me pranimin e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, e drejta e BE-së do të interpretohet në frymën e Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, jo vetëm si parim i përgjithshëm i së drejtës së UE-së, por edhe si Konventë drejtpërdrejtë e zbatueshme në të cilën mbështetet UE-ja.³

Traktati i Lisbonës ka përcaktuar objektiva të reja sociale të cilat kanë të bëjnë me: promovimin e nivelit të lartë të punësimit, zhvillimin e dialogut social të mirefillte, luftën kundër përjashtimit social dhe nivelit të lartë të edukimit, trajnimit dhe kycjes së të drejtave të femijeve në agjendën e aktiviteteve të Unionit.

• **Punësimi:** Unioni vazhdon të udhëheq politikë të koordinuar të punësimit me obligime të qarta për realizim në shtetet-anëtare në periudha të caktuara.⁴

TFUE nuk parashef zgjerim të kompetencave të BE-së në fushën e punësimit. Sipas nenit 2(3) të reviduar të TFUE, potencohet se "Unioni duhet të punon në arritjen e punësimit të plotë dhe

progresit social", ndërsa punësimi mbetet çështje e interesit të përbashkët ku sipas nenit 2D Unioni duhet të ndërmer masa për të siguruar koordinimin e politikave të punësimit të shteteve anëtare.

Nevoja për promovimin e shkallës së lartë të punësimit, mbrojtje adekuate sociale, lufta kundër përjashtimit social, duhet të merren parasysh gjatë definimit të politikave dhe aktiviteteve të Unionit (neni 5), dhe në veçanti Unioni në definimin dhe realizimin e politikave të veta duhet të lufton diskriminimin e bazuar në gjini, racë, prejardhje etnike, religjion dhe besim, moshë (neni 5b).

• **Dialogu social:** Konfirmohet roli i partnerëve social në zhvillimin e dialogut social. Konkretisht, Unioni njih dhe promovon rolin e partnerëve social në nivel Evropian, duke mbajtur llogari për diversitetin e sistemeve nacionale (neni 136a). Unioni duhet të lehtësojë dialogun social mes partnerëve social, duke respektuar autonominë e tyre.⁵

• **Arsimi, trajnimi profesional dhe të rinjtë:** Në nenin 165(2) të Traktatit mbi funksionimin e UE-së, potencohet se veprimet e Komunitetit janë të nevojshme për të inkurajuar participimin e personave të rinj në jetën demokratike në Evropë. Kyçja në Traktat e dispozitave specifike mbi participimin e personave të rinj në jetën demokratike në Evropë përbën zgjerim domethënës të kompetencave të BE-së përtej veprimeve të cilat tanimë zënë vend.

• **Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve:** Kryesisht, BE-ja nuk parasheh baza të qarta për udhëheqjen e një politike të vetme të harmonizuar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por kjo sferë kryesisht është lënë të rregullohet në nivel nacional nga vetë shtetet-anëtare, ndërsa interesat e fëmijëve janë mbuluar me sferat tjera politike për veprim të BE-së (të drejtat e njeriut, arsimit etj).

Traktati i Lisbonës bën një hap përpara për fëmijët, në nenin e ri 3(3) Traktatit të UE-së janë bërë ndryshime të rëndësishme në favor të të

³ Holroyd A., "A guide to the Treaty of Lisbon: European Union insight", The Law Society, Janar 2008, f. 17-18

⁴ Vlen të përmendet Strategjia Evropiane për punësim (SEP), e miratuar në samitin e Këshillit Evropian në Luksemburg (20-21 nëntor 1997), si mjet kryesor për drejtim dhe koordinim të politikës së punësimit në nivel të shteteve-anëtare të BE-së, përmes "Metodës së bashkëpunimit të hapur". Kritika të shumta ishin adresuar SEP-së lidhur me objektivat, gjegjësisht ndikimit të vërtetë të Strategjisë për luftën kundër papunësisë, pasi që ajo bazohet në Udhërrëfyes dhe rekomandime dhe nuk parashihte sanksione të posaçme për mos- implementim e saj, madje nuk parashihej edhe mjete të nevojshme financiare nga fondet strukturore për realizimin e saj. Poashtu, kontributin e tyre në politikën e punësimit e dhanë edhe samitet vijuese të Këshillit Evropian. Nga të gjitha raportet e Komisionit Evropian dhe dokumentet tjera, i pakontestueshëm është fakti se ato kanë ndikim pozitiv mbi politikën nacionale të punësimit dhe në përmirësimin e strukturës së tregut të punës në shtetet-anëtare.

⁵ Theksimi i rritur i dialogut social poashtu është i rëndësishëm, pasi që akoma nuk është i përfshirë aq sa duhet në vendet anëtare, veçanërisht në biznesin e vogël.

drejtave të fëmijëve: “Unioni duhet të lufton përjashtimin social dhe diskriminimin, dhe duhet të promovon drejtësi dhe mbrojtje sociale, barazi mes burrave dhe grave, solidaritet mes gjeneratave dhe mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”. Dispozitat e këtij neni nuk i japin fuqi të re UE-së në këtë drejtim, mirëpo në fusha tjera politike do të mundëson të ndërmerren masa specifike për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Si pjesë e këtij procesi, të drejtat e fëmijëve do të merren në konsideratë dhe do të realizohen përmes politikave të BE-së.

Nenet 9 dhe 10 të TFUE kanë rëndësinë e veçantë për shkak se “fëmijët dhe të rinjtë janë të prekshëm ndaj efekteve të varfërisë dhe përjashtimit social, ato janë të ndjeshëm ndaj diskriminimit dhe shëndetit publik dhe çështjeve të arsimit, në drejtim të ndikimit ndaj fëmijëve.

Fushë me rëndësi të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve paraqet liria, siguria dhe drejtësia, pasiqë trafikimi i fëmijëve dhe eksploatimi i tyre tanimë shpërndahet në aktivitetet e BE-së në luftimin e krimin ndërkufitar, megjithatë Traktati i Lisbonës do të ndihmon në përforcimin e të drejtave të fëmijëve në perspektivë afatgjate dhe do të integron ato në aktivitetet e veta.

Por, vete kyçja e të drejtave të fëmijëve në mesin e objektivave të Traktit do të ketë ndikim të rëndësishëm në përgatitjen e instrumenteve të ardhshme legjislative, si lëndë e diskutimit të ndikimit të tyre mbi të drejtat e njeriut.

3. Risitë në procesin e vendimmarrjes mbi çështjet sociale në Traktatin e Lisbonës

Legjislacioni sekondar i UE-së në fushën sociale aprovohet me shumicë të kualifikuar.⁶ Aq me tepër sa që me Traktatin e Lisbonës, Këshilli Evropian mund të vendos dhe të transferon në shumicë të kualifikuar një numër të

⁶ Kjo përfshin: përmirësimin e kushteve për punë në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve; kushteve të punës; informatave të dhëna dhe konsultimin e punëtorëve; integrimin e personave të përjashtuar nga tregu i punës; barazinë mes burrave dhe grave vështruar nga shanset e qasjes së tyre në tregun e punës dhe mënyrën se si ato trajtohen në punë; luftën kundër përjashtimit social dhe modernizimi i sistemeve të mbrojtjes sociale.

konsiderueshëm të fushave (për të cilat duhet vendosur sipas rregullit me unanimitet), e që kanë të bëjnë me:

- bashkëpunimin mes shteteve anëtare në mbrojtjen e punëtorëve në rast të mbarimit të kontratës së punës;
- përfaqësimin kolektiv dhe mbrojtjen e interesave të punëtorëve dhe punëdhënësve;
- kushtet e punësimit të qytetarëve nga vendet e treta të cilët punojnë në mënyrë legale në UE.

Ky element do të bën të mundshëm mënjanimin e çfarëdo qoftë bllokade potenciale në këtë fushë, ndërsa njëzëshmëria akoma është mbajtur për disa sfera.

“Frenat e dorës” në sigurimin social paraqesin një nga “linjat e kuqe” të qeverive. Masat në fushën e sigurimit social për punëtorët emigrant dhe personat në varshmëri nga ato deri me tani janë aprovuar me unanimitet (neni 42 i Traktatit të BE-së), mirëpo sipas Traktatit të Lisbonës do të kalon në votim të shumicës së kualifikuar. Në drejtim që të ruan autonominë financiare të shteteve anëtare, Britania e Madhe kishte negociuar “frenat e dorës” me çka shtetet anëtare mund të kërkojnë që masat e propozuara nga Këshilli Evropian nuk do t’i dëmtojnë aspektet e rëndësishme të sistemeve të tyre sociale (neni 48 Traktatit për funksionimin e UE-së).⁷ “Frenat e dorës” të negociuara nga Britania e Madhe si masa të sigurimit social për punëtorët emigrant dhe personat në varshmëri të tyre janë të rëndësishëm nëse ato e arrijnë atë për çka janë dizajnuar.

KONKLUZIONE

Edhe me Traktatin e Lisbonës, Unioni do të vazhdon të jetë promotor i risive në fushën sociale në shtetet anëtare por edhe në ballafaqimin me sfidat e kohës.

Megjithatë, duke pasur parasysh se në botën bashkëkohore dallimet mes njerëzve të varfër dhe atyre të pasur janë gjithnjë e më tepër të theksuara, duket se ky Traktat nuk do të premtom sigurimin e drejtësisë sociale.

⁷ “The Treaty of Lisbon: an impact assessment”, Volume I: Report Published by the Authority of the House of Lords, Londër, 13 Mars 2008, f. 204-209

Si dokument bazë, Traktati tenton t'u jep kahe zgjidhjes së problemeve sociale me të cilat ballafaqohen qytetaret e Unionit Evropian. Mirëpo, deri me tani ky dokument nuk ka arritur të jetë i përsosur për t'i zgjidhur të gjitha problemet sociale, ndërsa për ato që do të paraqiten në të ardhmen do te duhet të ndërmerren hapa konkrete në plotësimin e dispozitave të tij.

BIBLIOGRAFIA

Azizi A., "Puna dhe politika sociale në Bashkimin Evropian", Tetovë, 2009

Holroyd A., "A guide to the Treaty of Lisbon: European Union insight", The Law Society, January 2008

Treaty of Lisbon amending the Treaty on Uuropean Union and the Treaty stablishing the European Community (2007/C 306/01), Official Journal of the European Union 17.12.2007

"The Lisbon Treaty: 10 easy-to-read fact sheets", Fondation Robert Schuman, Brussel, December 2007

"The Treaty of Lisbon: an impact assessment", Volume I: Report Published by the Authority of the House of Lords, London, 13 March 2008.